

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe mr.sc. Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit NNT “B-R”, Komuna e Suharekës, të cilin e përfaqëson R.T., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë, për shkak të borxhit, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.06/2014, datë 03.02.2016, në seancën e mbajtur më 26.4.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit NNT “B.R.”, Komuna e Suharekës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.06/2014 datë 03.02.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.06/2014 datë 03.02.2016, refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit NNT “B.R.”, Komuna e Suharekës, dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.80/2011, datë 20.05.2013, me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për detyrimin e të paditurës që paditësit t’ia paguajë borxhin në shumën prej 12.452,63 €, në emër të kryerjes së punimeve ndërtimore shtesë, me kamatë prej 4% në vit, duke llogaritur nga dita e faturimit të borxhit e deri te pagesa definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet apo ato të prishen dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se ndërgjyqësit kanë qenë në marrëdhënie afariste për rinovimin e objektit të shkollës fillore “Dëshmorët e Kombit”, komuna e Suharekës, sipas kontratës së lidhur më 20.11.2008, në të cilën ishte parashikuar çmimi kontraktues në total prej

128,579,00€. Paditësi i ka përfunduar punimet ndërtimore pa ndonjë vërejtje, ndërsa e paditura ia ka paguar asaj në tërësi çmimin kontraktues. Në fazën e përfundimit të punimeve të kontraktuara, zyrtari i të paditurit z. N.D., me cilësi të mbikëqyrësit profesional të punimeve, ka vlerësuar se duhet të kryhen punime shtesë - suvatim dhe ngjyrosje e mureve përbrenda objektit. Punimet shtesë, të cilat i ka vlerësuar si të domosdoshme, ia ka rekomanduar punëkryerësit dhe i ka regjistruar në ditarin ndërtimor, duke ia përcjellë Departamentit të Prokurimit të MASHT-it. Ky i fundit nuk e ka dhënë pëlqimin me shkrim për punimet shtesë dhe fillimisht nuk ka iniciuar procedurë pranë APP-së për lejimin e procedurave të negociuara. Pas përfundimit të punimeve shtesë dhe lëshimit të objektit në shfrytëzim më datë 7.5.2009, MASHT, si porositësi i punimeve, ka paraqitur kërkesë pranë APP për përdorimin e procedurave të përkufizuara apo të negociuara, që kanë të bëjnë me lidhjen e kontratës për punimet shtesë. APP, më datë 13.5.2009, ka refuzuar kërkesën për lejimin e lidhjes së kontratës për punimet shtesë. OSHP, me vendimin e datës 16.12.2009, e ka refuzuar ankesën e paditësit, paraqitur kundër vendimit të APP, me arsyetimin se kërkesa për procedura të negociimit është bërë pas përfundimit të punimeve shtesë.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka gjetur se gjatë kryerjes së punimeve ndërtimore organi mbikëqyrës i të paditurës, me rastin e procedimit të mbikëqyrjes së punimeve, ka rekomanduar kryerjen e disa punimeve shtesë, të cilat i ka konstatuar dhe i ka specifikuar në librin e ndërtimit. Punimet shtesë të përmendura nuk janë autorizuar nga Departamenti i Prokurimit Publik i Komunës apo përmes marrjes së pëlqimit nga APP dhe, si të tilla, nuk gëzojnë mbrojtje gjyqësore sipas dispozitës së nenit 633 të LMD dhe nenit 34.2 pika (d) dhe 34.5 të LPP, nr.2003/17, andaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimit, ka pranuar si të drejtë dhe qëndrimin juridik dhe konstatimi faktik të gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së dytë në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta që do të ndikonin në ligjshmërinë e tij lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Ashtu, si të dy gjykatat e instancave më të ulëta, edhe kjo Gjykatë mendon se kërkesëpadia e paditësit për detyrimin e të paditurës për pagimin e borxhit për punimet shtesë, nuk gjen mbrojtje gjyqësore sipas dispozitës së nenit 633 të LMD, për faktin se, në rastin konkret, për kryerjen e punimeve shtesë, paditësi nuk kishte pëlqim me shkrim nga porositësi i punimeve, përkatësisht nga zyrtari përgjegjës në Departamentin e Prokurimit, si nënshkrues i kontratës. Me nënshkrimin e kontratës bazë, palët ndërgjyqëse kanë pranuar kushtet e përgjithshme të kontratës bazë për kryerjen e punimeve, ndërsa e paditura, në bazë të kësaj kontrate, i ka përmbushur obligimet ndaj paditësit. Ndërmjet palëve në rastin konkret nuk është lidhur një aneks-kontratë apo marrëveshje me të cilat do të përcaktoheshin të drejta dhe detyrime të tilla të palëve që do të kishin cilësinë e ofertës dhe kërkesës për kryerjen e punimeve shtesë. Punimet shtesë – punimet e paparashikuara me marrëveshje me të paditurën, nuk kanë bazë ligjore që do të mundësonte kompensimin e tyre. Propozimi i mbikëqyrësit të

projektit për punime shtesë dhe konstatimi në ditarin e ndërtimit i organit mbikëqyrës të së paditurës se duhet të kryhen punime shtesë nuk paraqet bazë ligjore për realizimin e një të drejte të tillë, pasi që punimet e tilla nuk bien në kompetencë të këtij organi. Ndërkaq, dispozita e nenit 630 par 2 të LMD parashikon shprehimisht se kontrata për ndërtimin duhet patjetër të lidhet në formë të shkruar, formë kjo që vlen edhe për ndryshimet e mëvonshme . Për këtë arsye, punimet që nuk janë kontraktuar nuk kanë efekte të vlefshme juridike dhe nuk gëzojnë mbrojtje juridike.

Për më tepër, edhe me dispozitën e nenit 34.2 pika (d) të LPP është përcaktuar se autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e negociuar te një kontratë për kryerjen e punimeve shtesë, të cilat nuk janë parashikuar më parë në kontratë apo projekt, nëse ato punime janë rezultat i rrethanave të parashikuara dhe janë të nevojshme për kryerjen e punimeve të parashikuara në projekt. Meqë punimet shtesë nuk janë autorizuar nga Departamenti i Prokurimit Publik i MASHT, si i vetmi autoritet kompetent për dhënien e pëlqimit për punime shtesë apo përmes marrjes së pëlqimit nga APP për lidhje të kontratës përmes procedurës së negociuar, në këtë rast paditësi nuk ka bazë ligjore për ta realizuar të drejtën e kompensimit të punimeve shtesë, ashtu siç ka vlerësuar me të drejtë gjykata e shkallës së parë.

Për arsyet e përmendura më lart, kjo Gjykatë i cilëson si të papranueshme parashtrimet në revizion se të dy gjykatat, me rastin e marrjes së vendimit, kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, duke mos i vlerësuar në mënyrë objektive shkresat e lëndës.

Kjo Gjykatë i vlerësoi parashtrimet në revizionin e paditësit se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, por gjeti se ato janë të papranueshme për faktin se me to vetëm përshkruhet gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, duke mos u bërë saktësimi dhe arsyetimi i pretendimeve për këto shkelje në kuptim të ligjit, ndërsa gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur brenda kufijve dhe shkaqeve të vëna në dukje në revizion (neni 215 i LPK).

Objekt i shqyrtimit kanë qenë edhe parashtrimet e tjera në revizion, por pa ndikim në zgjidhjen e çështjes konkrete, pasi që në revizion paditësi përshkruan përmbajtjen e provave, pa dhënë arsye lidhur me shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Nga sa u tha më sipër dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
E.Rev.nr.20/2016 datë 26.04.2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani